

- 2 Lëvizja e lirë e personave dhe masat shoqëruese**  
Mbrojtje pagash – më shumë të drejta për punonjësit
- 3 Projekti PROGRESSO**  
Arsim themelor për punonjësit e gastronomisë
- 4 Arsimi i personave të besueshëm sindikalist**  
Seminari i sindikalistve shqiptar të Unia-s

Nr. 7 | dhjetor 2018 | shqip

Botohet si shtojcë në gazetën «work» | Redaksia T +41 31 350 21 11, F +41 31 350 22 11 | info@unia.ch | www.unia.ch

## Financat si kriteri më i lartë Shtrëngatë ligjore për lejet e të huajve



Pamje e huazuar nga Vrojtorja zvicerane për të drejtën e azilit dhe të të huajve SBAA

**Nga 1 janari 2019 do të filloi zbatimi i «ligjit federal për të huajt dhe për integrim» (AIG). Krahas përmirësimeve të pakta ai përmban edhe përqesime të shumta: Lejën e përhershme (C) tani e marrin vetëm që janë të integruar mirë. Migrantet/ët edhe ashtu ka kohë që përballen me një frymë të ashpër, nëse papritur kanë një situatë të vështirë financiare, sikur edhe dokumenton Qendra zvicerane për vëzhgim të së drejtës për azil dhe të të huajve (SBAA).**

«Maria» në vitin 2004 pas martesës me një zviceran merr lejen vjetore të qëndrimit B. Pas ndarjes ish burri i saj refuzonte të paguante për mbajtjen e djalit të përbashkët, për shkak se aji ishte e varur nga parapagesa. Me 2012 enti për migracion ia tërhoqi vërejtjen «Maria»-s dhe e kërcënoi me heqjen e lejes B, pasi ajo mernte ndihmë sociale. Qëndrimi i saj arsyetues ishte injoruar. Tek pas shkrës së avokatit të saj me theksimin e faktit se varësia e saj nga ndihma sociale kishte ndodh pa fajin e saj dhe se «Maria» në ndërkohë kishte gjetur një vend të plotë punë, u tërhoqe vërejtja dhe iu vazhdua leja B (Rasti nr. 251 i SBAA).

### Humbja e lejes së qëndrimit tek ndihma sociale

Sipas ligjit për të huajt lejet e qëndrimit mund të anulohen, nëse një person është i varur nga ndihma sociale. Mirëpo, kushdo që pa fajin e vet varet nga ndihma sociale nuk duhet të bartë pasojë. Megjithatë shembulli i «Maria»-s nuk është një rast të vetëm siç tregon e dëshmon edhe raporti profesional i SBAA «Jeta familjare – (pa) të drejtat

njerëzore» (2017). Në vitet e kaluara praktikant e autoriteteve në ndërlidhje me vazhdimin dhe anulimin të lejeve të qëndrimit dëshmojnë përqesimin. SBAA ka dokumentuar edhe heqjen e lejeve të qëndrimit me rastin e varësisë së pafajshme të nga ndihma sociale.

### Kriteri financiar edhe tek bashkimi familjar

Edhe në ndërlidhje me bashkimin familjar marrëdhëniet financiare gjithnjë e më shpesh bëhet kriter më me peshë: Sikur vjen në përfundim SBAA, Kantonet me rastin e kërkesave për bashkim familjar shpesh nisen nga dyshimi i varësisë financiare në të ardhmen dhe vlerësojnë atë më lartë se sa të drejtën e jetës familjare.

### Nxitja e integritimit, sipas federatës

Ligji i ri për të huajt (AIG) sipas autoriteteve federale duhet të nxisë më fuqishëm integrimin, gjegjësisht përmes punësimit fitimprurës. Në fakt integrimi në punë i refugjatëve me status të njohur dhe atyre përkohësisht të toleruar duhet përmirësuar, duke zëvendësuar procedurat

aktuale të stërzgjatura të lejeve të punës tek autoritetet me një lajmërim të zakonshëm. Punëdhënësi duhet të lajmëroi veprimtarinë si dhe të respektojë kushtet e punës, ato të vendit, profesionit dhe pagës për sektorët e caktuar ekonomik.

### Leja e qëndrimit kushtëzohet me integrimin

Ligji për të huajt (AIG) kushtëzon statusin e qëndrimit me integrimin. Si vlerësim i integritimit merren parasysh kompetencat gjuhësore dhe «pjesëmarrja në jetën ekonomike». Kërkesat përkitazi me kompetencat gjuhësore sa vijnë e bëhen më të larta, veçanërisht kur kanë të bëjnë me statusin juridik të të huajve. «Pjesëmarrja në jetën ekonomike» (punësimi) është kusht dhe përjashtim ka vetëm në rastin e paafësive, të cilat kufizojnë rrethanat jetësore, apo në rast të obligimeve të kujdestarisë. Ligji nuk përmend si një përjashtim të mundshëm «asistencën sociale pa faj personal». Se sa problematike mund të jetë kjo tregojnë edhe shembujt e SBAA: Qysh tani autoritetet edhe në rast të pafajësisë për ndihmë sociale zbatojnë praktika të rrepta të lejeve.

### Leja-C mund të anulohet

Kushdo që posedon leje të përhershme qëndrimi, mund edhe ta humb atë. Kjo edhe deri më tani ka qenë e mundur, si në rastin e shkeljeve tek rendi dhe siguria publike, apo me rastin e marrjes të përhershme të ndihmë sociale. Me ligjin e ri autoritetet në rast të integritimit të pamjaftueshëm mund të zëvendësojnë lejen e përhershme të qëndrimit C me atë vjetore (lejen-B) apo edhe ta anulojnë tërësisht. Zyrtarët e migracionit kanë mundësinë që lejen e qëndrimit ta ndërlidhin me një kontratë integrimi.

### Pasiguri tek të prekurit

Me ndryshimet ligjore për migrantët, statusi ligjor për të huajt do të vret nga kërkesat e larta të kontributeve dhe dëshmimeve integruese. Bashkë me ashpërsimin e praktikave të autoriteteve për dhënie e lejeve, pasiguria sa i përket qëndrimit në vitet e ardhshme do të vjen duke u rritur. Para së gjithash kur migrantet/ët gjenden në vështirësi financiare.

Noëmi Weber (SBAA) dhe Marília Mendes

### Editorial



### Të dashur/a lexues/e

Është 25 nëntori dhe unë jam duke shkruar me ndjenja të përziera. Arsyet për të festuar është e madhe: Sot populli zviceran ka refuzuar qartas (me 66% vota kundër) iniciativën «vetëvendosëse» të SVP/UDC-së dhe kështu ka dëshmuar vlerat themelore të demokracisë dhe të Zvicrës së hapur karshi botës me një sistemi funksional juridik. Pasi iniciativa «vetëvendosëse» ka paraqitur një sulm të paskrupull kundër të drejtave themelore dhe ato të njeriut, pa të cilat një demokraci nuk mund të funksionojë. Ky ishte gjithashtu edhe një sulm kundër të drejtave të punëmarrësve. Përmes refuzimit popullata ka fuqizuar sindikatat në luftën për të drejtat e punëmarrësve.

Mirëpo, arsye për të festuar nuk na dha aprovimi i propozimit ligjit për detektivët privat, i cili mundëson zgjerimin e spiunimit të përfutësve nga pensioni i invaliditetit (IV/AI). Aprovimi i këtij projektligji kuptohet si refuzim i migracionit. Bazuar në komentet që ndërlidhen me votimin është fakti se votueset e votuesit i identifikojnë migrantët si përfutës të pensioneve të invaliditetit, gjë që ka kontribuar për të votuar për parashtresën në fjalë. Që edhe zviceranet/ët mund të preken nga sulmi në privatësi është anashkaluar fare. Kështu ky vendim përputhet edhe me klimën e mosbesimit karshi migrantëve/eve dhe plotëson pandarë përqesimet përkitazi me të drejtën e migrantëve, me të cilat merret artikulli po në këtë faqe.

Zërat nacionalistë ia kanë dalë që në kokat e njerëzve të mbjellin idenë që migrantët vijnë në Zvicër që ta shfrytëzojnë atë dhe të përfitojnë nga ajo. Me këtë rast horrohet se sa kontribuojnë me punën, me kulturën dhe me kontributet të tyre sociale migrantet/ët për Zvicrën dhe zviceranet/ët. Kështu demokracia zvicerane sot ka fituar shumë, mirëpo diçka edhe ka humbur.

Marília Mendes

News

**Njerëzit nga Marge: Mbledhja e delegatëve të Unia kërkon nga Novartis të heq dorë nga reduktimi**

Mbledhja e delegatëve të Unia kërkon nga Novartis, që të ndryshojë politikën e saj të personelit dhe më në fund përsëri të merr seriozisht përgjegjësinë sociale që ka karshi të punësuarve. Korporata në vitet e fundit ka rritur fitimin në 7,7 miliarda. Bile 11,7 miliarda franga iu janë shpërndarë aksonareve/ëve. Që në një situatë të tillë financiare të hidhen në rrugë 2000 të punësuar është tallje dhe absurde. Në mbledhjen e delegatëve, Unia aprovi edhe synimet vjetore për 2019-ën. Temat më të rëndësishme janë greva e grave e 14 qershorit 2019, mbrojtja e qarkullimit të lirë të personave dhe masave mbrojtëse si dhe luftimi i sulmeve borgjeze që i bëhen ligjit të punës.

**McDonald's: Duart larg nga Uber Eats**

Unia dhe sindikatat tjera në Bernë dhe Gjenevë kanë zhvilluar një aksion proteste para filialeve të McDonald's. Ato kërkojnë nga McDonald's që të heq dorë nga bashkëpunimi me dumping-furnizuesit Uber East. Edhe Uber East duhet që korrierët e saj ti kontrakttoi në mënyrë të rregullt dhe ti punësojë sipas rregullave të vlefshme të degës. Pos tjerash Unia ka kërkuar nga qeveria federale t' E ndërmarri masa kundër thyerjeve të organizuara ligjore që bëjnë Uber. Unia propozon krijimin e një Task Force të përbërë nga qeveria federale, partnerët social dhe sigurimeve shoqërore, të cilat duhet të zhvillojnë masa ndikuese për mbrojtjen e punëmarrësve të platformë-ndërmarrjeve.

**Konferenca e degës së molerëve e plastererëve (gipserëve)**

Konferenca e degës së molerëve e plastererëve ka marrë qëndrimë në përputhje me masat mbrojtëse (FlaM). Pasi: Ato me Kontratë Kolektive të Punës (KKP) janë me rëndësi mbijetese sikur për punëmarrësit ashtu edhe për NVM (ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme) të ndërmarrësve zviceranë. Masat mbrojtëse, ashtu sikur kërkon Unia shumë herë, janë të pa negociuara. Ishte i madh numri i anëtarëve të konferencës profesionale të molerëve dhe plastererëve në Volkshaus (shtëpinë popullore) të Cyrihut. Pasi temat e rendit të ditës për të gjithë kanë rëndësi ekzistenciale: masat mbrojtëse (FlaM), qarkullimi i lirë i personave si dhe KKP-të. Vetëm Kontratës Kolektive të Punës për molerë dhe plasterer aktualisht i nënshtrohen rreth 15000 të punësuar.

**KKP Pastrimi KKP e re nga 1 dhjetori 2018**

Kontrata e re kolektive e punës e degës së pastrimit, e cila pas aprovimit të qeverisë federale dhe publikimit ne SECO (Sekretariati shtetëror ekonomik) fuqizohet në Zvicrën gjermane nga 1 dhjetori 2018. Ajo është e detyrueshme për 900 ndërmarrje pastrimi. 1400 firma tjera vullnetarisht mund ti nënshtrohen kësaj KKP-je.

KKP-ja është rezultat i komisionit të paritetit të punëdhënësve dhe punëmarrësve të degës së pastrimit. Të tri organizatat Unia, VPOD dhe Syna përfaqësojnë punëmarrësit. Ndërsa, ndërmarrje të ndryshme pastruese, edhe ato të mëdha, me mandat nga shoqata Allpura angazhohen në krahun e punëdhënësve. Kontrata e përgjithshme e Punës fillimisht është përpunuar nga një delegacion i vogël negocimi dhe më pas është kontrolluar nga konferenca nacionale e regionale profesionale e sindikatave. Kështu që KKP me rastin e publikimit nga ana e SECO nuk ka pasur asnjë vërejtje.

**Ndërmarrjet pastruese kanë nevojë urgjente për punonjës të arsimuar** Dega e pastrimit përmes KKP-së së negociuar rishtas nga 1 dhjetori 2018 fuqizon jo vetëm pagat minimale prej 4500 frangave për pastrues ndërtesash me zanat të kryer (EFZ = certifikatë shtetërore aftësie) si dhe pagë shtesë për punën të dielave dhe natën. Rishtas paga minimale për punonjës pa arsimim bazë formal do të rritet për 5%, nëse ndjekin 80 leksione trajnimi të para-

para me KKP. Për këtë atyre u nevojiten të zotërojnë së paku njohuri elementare të gjermanishtes të nivelit A2.2. Sindikatat Unia, VPOD, Syna si dhe Allpura si shoqatë punëdhënësve janë të bindura se shkollimi trajnues është i përshtatshëm edhe për njerëzit me sfond arsimimi të varfër si dhe hap rrugën për marrjen e certifikatave tjera profesionale dhe se gjithashtu mund të bartet edhe në degët tjera ekonomike. Sindikatat dhe punëdhënësit kanë krijuar arsimime sistematike për njerëzit me njohuri themelore të gjermanishtes.

«Reine Profis» është rezultat i angazhimit të Punëdhënësve dhe Punëmarrësve të degës së pastrimit të Zvicrës gjermane. Zhvillon kompetencat e gjermanishtes dhe kualifikimin profesional të 65000 punonjësve nga mbi 100 vende.

reineprofis.ch • wir.reineprofis.ch • facebook.com/reineprofis • twitter.com/reineprofis

Osman Osmani



Të punësuarit në degën e pastrimit kanë nevojë për arsimim të mëtejshëm



**Lëvizja e lirë e personave dhe masat shoqëruese Mbrojtje pagash – më shumë të drejta për punonjësit**

Zvicra është në mes të Evropës. Më shumë se gjysma e të gjitha eksporteve zvicerane shkojnë në Bashkimin Evropian (BE). Për një ekonomi të qëndrueshme, Zvicra ka nevojë për marrëdhënie të mira dhe të rregullta me BE. Kjo është arsyeja pse Zvicra ka lidhur marrëveshje bilaterale me BE. Në të njëjtën kohë, puna në Zvicër po bëhet gjithnjë e më e pasigurt. Mbrojtja e pagave po sulmohet. Unia është e angazhuar për të siguruar që pagat zvicerane të paguhen në Zvicër. Të gjithë të punësuarit kanë të drejtë të punojnë në kushte dinjitoze.

Gjithkush ka të drejtën për punë të sigurt dhe dinjitoze Unia lufton diskriminimin e pagave dhe dëshiron të parandalojë që punëtorët vendor të rixten kundër atyre që vijnë nga hapësirat e BE-së. Tashmë ne kemi arritur shumë përmirësime.

**Lufta kundër dumpingut në paga** Falë presionit të sindikatave, Zvicra ka prezantuar masat mbrojtëse shoqëruese (FlaM) për lëvizjen e lirë të personave. Ato duhet të mbrojnë pagat dhe kushtet e punës të të gjithë të punësuarve. Për këtë autoritetet, sindikatat dhe shoqatat e punëdhënës-

ve kanë zhvilluar një mekanizëm kontrolli. Kështu mundësohet kontrolli i kushtet e punës për punëtorët e dërguar nga BE

**Vijat e kuqe dhe zgjerimi i të drejtave** Qeveria federale po negocion aktualisht një marrëveshje institucionale kornizë me Bashkimin Evropian. Unia dëshiron marrëdhënie të qëndrueshme me BE. Por është e pamundur që mbrojtja e pagave dhe kushteve të punës të dobësohet si pjesë e marrëveshjes. Nëse ndodh e kundërta, sindikatat do ta luftojnë me gjithë fuqinë e tyre.

Osman Osmani

Unia dëshiron të përforcojë edhe më tej masat e pamjaftueshme mbrojtëse. Për shembull, duke lehtësuar vlefshmërinë e KKP me detyrim të përgjithshëm dhe për të mundësuar më shumë kontrolle.

**Për punë të sigurt dhe dinjitoze** Mbrojtja e pagave dhe të drejtat e punonjësve në Zvicër duhet të forcohet. Unia do të vazhdojë të ushtrtojë presion me veprime dhe mobilizime dhe do të hetojë e sqarojë pa mëshirë rastet e dumpingut në paga.

**Projekti PROGRESSO – Arsim themelor për punonjësit e gastronomisë Me lojën Progresso të tejkalohe barrierat gjuhësore**

**Bazel. – Shqetësimi për mungesën e njohurive të gjermanishtes shpesh paraqesin një barrierë të pabazuar për punonjësit e industrisë së gastronomisë e hotelerisë, të cilët dëshirojnë të përfundojnë arsimin bazë Progresso. Loja e re Progresso tani ofron një ndihmesë dhe i motivon ata që janë të interesuar duke lozur që të provojnë se janë të përgatitur gjuhësisht për kursin Progresso.**



Loja Progresso, e cila menjëherë mund të lozet falas në www.game.mein-progresso.ch, mundëson një qasje të gjallë për shprehjet profesionale të industrisë së gastronomisë e hotelerisë. Përdoruesit mund të trajtojnë tre nivele me vështirësi të ndryshme në lëmin e kuzhinës, shërbimit dhe ekonomisë shtëpiake. Duke përcaktuar shprehjet dhe aktivitetet me anë të kontrollit të prekjes, ata përmirësojnë e ngrisin rezultatin e tyre më lartë dhe në të njëjtën kohë duke luajtur mësojnë disa terma të rëndësishëm profesionale. Vendimi

për këtë lloj të marketingut modern të arsimit të mëtejshëm ishte gjithashtu për shkak të faktit se pothuajse të gjithë profesionistët sot kanë një smartphone. Për shembull, Progresso-Game mund të përdoret gjatë udhëtimit për në punë ose gjatë një pushimi. Loja është projektuar qëllimshëm në mënyrë që sipas nevojës të luhet vetëm për disa minuta dhe pastaj mund të ndërpritet dhe të vazhdojë përsëri të luhet sa herë që është e përshtatshme. Qasja në lojë është bërë sa më e lehtë që është e mundur: funksionon në të gjithë ofrues-shfletuesit, nuk duhet të shkarkohet dhe ka kontroll intuitiv prejkeje.

**Aplikimi «Gamification» po hyn në industrinë e gastronomisë**

Loja Progresso nuk është një mjet për mësimin e gjuhës, por të interesuar në një mënyrë të gjallë dëshirojnë tu ndërmjetësojë pak më shumë vetëbesim në përdorimin e aftësive të gjuhës gjermane. Pasi komunikimi në gjermanisht për të përfunduar kursin Progresso në Zvicër gjermanofolëse me shkathtësi të përshtatshme leximi dhe shkrimi është një nga parakushtet. Me masa

të tilla loje të aplikimit gamification, industria e gastronomisë është gjithashtu duke ndjekur shtigje të reja dhe premtuese në marketing të arsimit të vazhdueshëm. Studime të shumta kanë treguar tashmë se përmbajtja mund të ndërmjetësohet në mënyrë më efektive nëse ajo «gamificohen».

**Njohja e arsimin bazë në gjithë Zvicrën**

Çdo vit rreth dyqind të diplomuar kryejnë provimin përfundimtar të programit të arsimit bazë Progresso në fushat e kuzhinës, shërbimit, ekonomisë shtëpiake dhe sistemit të gastronomisë me qëllim të marrjes së dëftesës që njihet në të gjithë industrinë e gastronomisë e hotelerisë, të cilët ende nuk janë të diplomuar në këtë industri..

**Mësoni më shumë për kurset e Progressit në: www.mein-progresso.ch; www.hotelgastro.ch; www.l-gav.ch**

**Ekonomistët e Unia propozojnë nismën kundër papunësisë masive në Evropë Më shumë vende punë në vend të rritjes së profitit**

**Cili është problemi më i madh i Evropës? Refugjatët? Ngritja e partive të ekstremit të djathtë? Moti i nxehtë? Rrëzimi i urave të autostradave? Asnjë nga këto. Ekonomistët e Unia e thonë shkurt e qartë: Është papunësia.**

Rreth 14 miliona njerëz kanë përfunduar në rrugë dhe nuk mundur të gjejnë një punë tjetër. Ata janë në siklet, varen nga shteti dhe shpesh zhjyten në depresion. Por ky fakt nuk zgjon interesim tek politika.

**Të investohet në punësim**

Korporatat duhet më në fund të riinvestojnë dhe të krijojnë më shumë vende pune në vend që të devijojnë fitimet e tyre të larta në xhepat e menaxherëve dhe aksionarëve. Punësimi i plotë ishte dikur tema më të mëdha dhe më të rëndësishme të lëvizjes punëtore. Qysh në vitet 1970, ky edhe ishte qëllimi i vetëkuptueshëm i çdo politike ekonomike

**Më shumë se një ëndërr në diell**

Por pastaj fjala për punësimin e plotë u zhdruk qetësisht nga fjalori politik. Sipas llogaritjeve të Baumann dhe Bucheli, në BE do të duhej të krijohej 12 milion vende të reja pune. Kështu papunësia do të binte nën pragun dy për qind dhe do të mund të flisnim për punësim vërtet të plotë. Bachmann dhe Bucheli duan që të plasojnë idenë e tyre tek federatat ndërkombëtare të sindikatave.

**Ideja i shërben edhe Zvicrës** Kërkesë-parashtresa për punësim të plotë gjithashtu do tu sjellte përfitime edhe punonjësve të Zvicrës, si vend jo-

BE. Çdo i dhjetë vend-punë në Zvicër vjen nga një korporatë shumëkombëshe me seli jashtë vendit. Zvicra, sipas parashikimeve do ti bashkohej vullnetarisht këtij objektiv punësimi. Kjo do të parandalonte që vendet e punës të transferoheshin në vendet e BE-së.

Baumann gjithashtu sheh efekte pozitive mbi migracionin brenda Evropës: «Nëse ka punësim të plotë, atëherë do të thotë që njerëzit gjejnë punë në vendin e tyre dhe nuk kanë nevojë të emigrojnë».

O. Osmani, marrë dhe përshtatur nga Work,



Ekonomisti i Unia-s Christoph Bucheli gjatë një proteste

**I papunë: Shumë pyetje e disa përgjigje**

Të qenit pa punë është e vështirë dhe hap shumë pyetje. Është me rëndësi të ndërmerrin hapa të drejtë dhe të njihen të drejtat dhe obligimet. Për ju, ne kemi përgatitur disa pyetje dhe përgjigje. Në ueb faqen e arkës së papunësisë të Unia-s mund të gjeni përgjigjet të detajuara dhe përgjigje në pyetje tjera: <https://ohne-arbeit.ch/gut-zu-wissen/>.

**Mua më kanë shkarkuar nga puna – çka duhet të bëjë?** Së pari kontrolloni se a është respektuar afati ligjor i shkarkimit. Nëse në Kontratën tuaj të punës nuk është shënuar, atëherë vlejnë afatet e prishjes së kontratës sipas të drejtës obligative të Zvicrës:

Koha	Afati i shkarkimit
Gjatë kohës provuese	7 ditë në nërën nga ditët e dëshiruara
Në vitin e parë të shërbimit	1 muaj në fund të njërit prej muajve
Në vitet 2. – 9. të shërbimit	2 muaj në fund të njërit nga muajt
Nga 10 vite e më shumë shërbim	3 muaj

**Si, kur dhe ku duhet të lajmërohem si i papunë?** Ju duhet vet personalisht të lajmëroni papunësinë tuaj, më së voni që nga dita e parë që keni të drejtën në kompensim në rast papunësie! Lajmërimi duhet bërë në një entin regional për ndërmjetësim të punës (RAV), në afërsinë tuaj apo në administratën e komunës suaj. Se çka vlen për komunën tuaj dhe se cilat dokumente duhet të merrni me veti, mund të mësoni në portalin vijues informativ: <https://www.ch.ch/de/arbeitslosigkeit-anmelden/>.

**Kur kam të drejtë përfitimi nga kompensimi papunësisë?** Nëse ndër të tjera i plotësoni parakushtet vijuese: Brenda dy viteve të fundit para lajmërimit të parë të mund të dëshmoni se keni paguar kontributet ne 12 muajt e fundit, se jeni të aftë për tu ndërmjetësuar për punë (gatishmëri, në gjendje dhe të drejtë të nisni një punë) dhe nëse i përmbaheni rregullave të kontrollit të Entit për ndërmjetësim të Punës (RAV).

**Për sa kohë do të marr kompensimin për papunësi?** Se ditë ju takojnë të përfitoni varet nga koha e kontributeve dhe moshës suaj:

Numri i mëditjeve	Koha e kontributeve (në muaj)	Mosha
200	12 deri 24	deri 25
260	12 deri < 18	nga 25
400	18 deri 24	nga 25
520*	22 deri 24	nga 55

**Çka janë ditët e pritjes?** Në ditët e para të papunësisë nuk merrni menjëherë kompensimin. Mirëpo obligimet e juaja karshi sigurimit të papunësisë duhet ti kryeni paraprakisht. Numri i «ditëve pritëse» varet nga paga e juaj e siguruar dhe nga ajo, se a keni detyrime për mbajtje të fëmijëve.

**Cilave obligimeve duhet ti përmbahen unë?** Ju duhet të përpiqeni aktivisht për një vend pune; ju duhet ti dokumentoni aplikimet tuaja dhe duhet t'ia dëshmoni këshilltaresë/it tuaj të RAV-it (ruani aplikimet e juaj dhe refuzimet e mundshme); Ju duhet ta pranoni një vend pune të «aplikueshme»; Urdhëresat e RAV-it duhet ti ndiqni dhe të paraqiteni në të gjitha terminet e bisedave; Të gjitha informatat relevante që ndërliohen me të drejtën e juaj të përfitimit duhet t'ia komunikoni pa zvarritje sigurimit të papunësisë; shembulli bie kur të jeni sëmurë dhe nëse keni gjetur ndonjë punë temporale.

**Çka janë ditët e ndalesës?** Nëse i lëndoni obligimet tuaja, e drejta juaj e përfitimit të kompensimit mund t'ju hiqet përkohësisht. Këto «ditë të ndalesës» mund t'ju vihen si barrë nëse vet keni dhënë dorëheqje nga vendi i punës; nuk jeni përpjekur mjaftueshëm për gjetjen e një vendi pune; nuk keni respektuar rregullat dhe urdhëresat e RAV-it; nuk keni ndjekur detyrimin për lajmërim-çlajmërim; keni ndikuar në përfitim të kompensim papunësie të padrejtë. Varësisht nga faji ditët e ndalesës mund të sillen nga 1-60 mëditje.

**A mund të kundërshtojë vendimin e sigurimit të papunësisë?** Vendimet dhe urdhëresat e entit zbatues juve ju komunikohen me shkrim. Në ndjekjen e mjeteve juridike të vendimeve gjithmonë cila është mundësia juaj nëse nuk pajtoheni me një vendim. Mirëpo, ne ju këshillojmë që fillimisht të kërkonit bisedë me entin që ka marrë vendimin.

**Sa e lartë është mëditjes ime?** Nëse keni të drejtë përfitimi nga kompensimi i papunësisë, juve për çdo javë do t'ju paguhen 5 ditë (e hënë deri e premte). Me kalkulatorin e ri të Arkës së Papunësisë së Unia-s keni mundësinë që për pak sekonda të përllogaritni kompensimin tuaj bazuar në të dhënat tuaja: <https://ohne-arbeit.ch/kalkulator/>.

Marilia Mendes

## Ju pyesni, Unia përgjigjet

### Aksident: Përse nuk paguan arka e pensionit pensionin e plotë?

Katër vjet më parë kam pasur një aksident të rëndë makinash dhe nuk kam qenë në gjendje të punoj që atëherë. Sigurimi i invaliditetit më ka dhënë një pension të tërë, dhe sigurimi i aksidentit më paguan një pension. Arka pensionale, nga ana tjetër, më shkroi se unë nga ajo çdo vit marr vetëm 8800 franga. Megjithatë, sipas certifikatës së pensionit të arkës time pensionale, kam një të drejtë më të lartë për invaliditetin. Pse nuk e marr pensionin e premtuar të invaliditetit nga arka pensionale?

**Regula Dick:** Në ligjin e sigurimeve shoqërore, supozohet se personat që kanë të drejtën e përfitimeve sipas skemave të ndryshme të sigurimeve shoqërore nuk duhet të mbikompensohen. Në të njëjtën kohë ju keni të drejtë për një pension nga sigurimi i invaliditetit, sigurimi i aksidenteve dhe arka pensionale. Nëse keni marrë një pension të pakufizuar nga të gjitha këto sigurime, të ardhurat tuaja mund të jenë më të larta në të ardhmen sesa kanë qenë para aksidentit tuaj. Prandaj duhet të bëhet një llogaritje e mbikompensimit. Pensionet e sigurimit të invaliditetit (IV/AI), sigurimit të aksidenteve dhe arkës pensionale nuk mund të kalojnë 90 përqind të humbjes së supozuar të të ardhurave, me ç'rast pensioni i IV/AI gjithmonë paguhet i plotë, pra i pa shkurtuar. Humbja e pretenduar e të ardhurave është e barabartë me të ardhurat që i keni pasur para invaliditetit. Në rastin tuaj, arka pensionale - përveç pensionit IV dhe sigurimit të aksidentit - do të paguajë vetëm diferencën në mënyrë që të merrni gjithsej 90 përqind të të ardhurave që keni pasur para invaliditetit.

Work, 2.11.2018



### Lehonia: A mundem më herët përsëri të filloi profesionin?

Kam lindur një vajzë 10 javë më parë, jam në leje lindjeje dhe marr kompensim të lehonisë. Unë jam 60 për qind e punësuar në një ordinancë të përbashkët si fizioterapiste. Përveç kësaj, kam një punë tjetër me kohë të pjesshme prej 40 për qind në një spital privat. Tani së fundi më thirri mbikëqyrësi nga puna në spital. Dy nga kolegët e mi janë të sëmurë. Prandaj ata janë të mbingarkuar me punë dhe mbështeten tek unë me shpresë së mund të fillojë punën përsëri javën e ardhshme. Natyrisht, që do të shfrytëzoja të drejtën e pauzave të nevojshme për të ushqyer fëmijën. A duhet t'i përgjigjem kësaj kërkesë? Unë nuk dua të lë kolegët e mi në baltë, por edhe jam në mëdyshe.

**Mirjam Brunner:** Jo, nuk duhet. E drejta për përfitimet e kompensimit në rast lindjes pushon sapo të ktheheni në punë, posa të keni fituar më shumë se 2300 franga në vit. Në rastin tuaj, ju mund të supozohet se tejkalohet ky kufi page. Pra, nëse punoni përsëri para mbarimit të lejes tuaj të lindjes, ju humbni të drejtën për të gjitha përfitimet kompensuese të lindjes, që nga fillimi i punës.

Work, 2.11.2018

## Arsimi i personave të besueshëm sindikalist Seminari e shqiptarëve të Unia-s

Një grup sindikalistësh shqiptarë një herë në vit kuvendojnë shtruar për aktualitetin dhe të ardhmen e këtij komuniteti në Zvicër. Sivjet ata u takuan në Lozanë. Lista e synimeve të tyre është e gjatë dhe e rëndë.



Buzë liqenit në Lozanë këtë fundjavë u sistemuan rreth dyzet sindikalistë shqiptarë të Unia-s, nga të gjitha rajonet e Zvicrës dhe nga të gjitha viset e shqiptarëve. Ata ishin aty për seminarin e tyre tanimë tradicional, me një agjendë që nuk lejonte më shumë kënaqësi se një vrap në pedonalen buzë liqenit, nga ku horizonti ravijëzohet mbi brigjet e Francës vis-à-vis.

### Një shans i volitshëm

Sikurse me të drejtën e votës për migrantët në rrafsh lokal dhe kantonal, Gjeneva vazhdon t'u prijë proceseve për integrimin e të huajve në Zvicër. Për këtë dëshmuar anëtarët e Unia-s nga ky qytet, Linda Rexhaj Maliqi, Nasuf Nuhui dhe Floreta Jashari. Ata janë të përfshirë në projektin «Papyrus», që i legalizon personat «në të zezë», apo «sans-papiers», të cilët mund të provojnë pesë, përkatësisht dhjetë vjet qëndrimi në Gjenevë, se kanë një vend pune, se janë financiarisht të pavaruar, kanë njohuri të caktuara të frëngjishtes dhe nuk janë ndjekur penalisht. Projekti është i afatizuar deri në fund të 2018-tës. «Papyrus» pra!

### Mbi të Drejtën Ndër-kombëtare

Unia nuk do të ishte kjo që është, sikur të ishte indiferente ndaj aktualitetit politik. Një pjesë të vëmendjes së këtij seminari dyditor e morën dy iniciativat, për të cilat do të votohet me 25 nëntor në Zvicër. Në konceptin e sponsorëve të iniciativës e drejta vendore duhet të prevalojë mbi të drejtën ndërkombëtare. Në instancë të fundit kjo iniciativë përbën një agresion mbi demokracinë e të drejtat e njeriut. Ajo mund të suspendon Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe Gjykatën Federale si dhe Konventat e Organizatës Ndërkombëtare të Punës (IAO), e cila i përcakton të drejtat e punonjësve. Kështu iniciativa i kanos drejtpërdrejt segmentet që përfaqëson Osmani dhe auditori: punëtorët.

Jo më pak përfillje gjen iniciativa tjetër, për agjentët privatë të sigurimeve shoqërore, ku autorizimet e tyre nganjëherë i kalojnë ato të policisë dhe të shërbimit sekret. Therori i parë i tyre është privatësia e qytetarëve. Osmani nuk heziton t'i dënojë abuzimet eventuale me ndihmat sociale, por si për të gjithë opinionin mendjehapur, veprimtaria e agjentëve konsiderohet joproporcionale në raport me rrezikun e abuzimit. Ai nuk mund të qëndrojë pa e shqujtur faktin se viktimitë e punës ilegale të këtyre gjurmuesve të ndërsyer nga sigurimet janë pensionet e mohuara të qytetarëve të Kosovës në vendin e tyre.



### Një imazh për homazh

Kampioni i diskutimeve në seminarin e grupit të shqiptarëve në Unia ishte Ruzhdi Ibrahim, specialist i sigurimeve shoqërore. Ibrahim ligjëron për marrëveshjet ndërshtetërore të sigurisë shoqërore. Dhe gjuha e tij shkon te dhemja e Marrëveshjes për Sigurimet Shoqërore ndërmjet Zvicrës dhe Kosovës. Ai thekson sihariqin se nga 18 qershori, përkatësisht 18 tetori i këtij viti është hapur perspektiva për pensionistët kosovarë të Zvicrës në vendlindjen e tyre.

Një ligjëratë të ndarë të Ruzhdi Ibrahimit përbën çështja e pagesave plotësuese, që në hapësirën gjermanofone njihen si «Ergänzungsleistungen» (EL). Këtu bën mirë të kihet parasysh që këto nuk janë e njëjta me ndihmën sociale dhe se ato financohen nga buxheti federal e ai kantonal. Dhe, se abuzimi me këtë të drejtë ndëshkohet.

Ligjëratat e tretë, dhe jo e fundit, e Osman Osmanit dhe Ruzhdi Ibrahimit i kushtojë asaj e cila nuk i ikën vetëm sindikalistëve shqiptarë dhe shqiptarëve të angazhuar në Zvicër: Marrëveshja për Shmangjen e Tatimit të Dyfishtë. Kjo paraqitje ishte e konceptuar bashkë me Luljeta Hajzerajn nga Rrjeti i Kishave Evangjelike të Zvicrës (HEKS/EPER). Marrëveshja ka hyrë në fuqi me 10 tetor 2018. E para marrëveshje Kosovë-Zvicër nga fusha e tatimeve!

Ligjëratave të Ruzhdi Ibrahimit iu prin para një imazh nga 100-vjetori i grevës së përgjithshme në Zvicër, e cila i ka nxitur arritjet e sistemit shoqëror zviceran. Një imazh për homazh!



### Sfond teorik i veprimit praktik

Hilmi Gashi, një eksponent tjetër i skenës së sindikalistëve shqiptarë të Unia-s në Zvicër, e ngre shkallën intelektuale të debatit. Ai sjell sfondin teorik të trajtave të «veprimit shoqëror». Temat e tij nuk janë më pak ambicioze se bazat, arsyet dhe mënyrat e këtij veprimi. Pastaj ai ndalon te veprimi individual dhe ai kolektiv. Në një këndvështrim interdisciplinar Gashi identifikon katër hapa për mobilizim kolektiv: simpatizimi me një ide e qëllimi, informimi mbi mundësitë e veprimit, zhvillimi i motivit për t'u angazhuar dhe tejkalimi - për shembull - i frikës nga pasojat e mundura.

Për fund ai prezanton disa pika, ku ka potencial për angazhim të komunitetit të sindikalistëve shqiptarë dhe më gjerë: barazia në paga, kontrata e ndërtimtarisë, forcimi i pozitës së shqiptarëve në Unia, bashkëpunimi me sindikata në Zvicër dhe në vendlindje, faktorizimi shoqëror i mërgatës. Me këtë edhe e hap debatin për grupet e punës së pjesëmarrësve.

### Vetëdije dhe kërkesa

Osman Osmanit, kryesuesit, organizatorit, morderatorit dhe ligjëruarit të seminarit i duhet të përpilojë një katalog të gjatë kërkesash të dala nga grupet e punës së sindikalisteve dhe sindikalistëve të seminarit të Unia-s kryesisht për grevën e grave 2019 dhe shqetësimet e preokupimet e sindikalistëve shqiptarë si në raport me Zvicrën ashtu edhe me vendet amë.

Kujtim Shabani, prointegra.ch